

## Informacionet për prindërit për paraleximin (leximin me zë të lartë) dhe tregimin

Të dashur Prindër,

të gjithë fëmijëve ju duket fantastike paraleximi (leximi me zë të lartë) dhe kqyrja së bashku i librave . Fëmijët i duan historitë. Gjatë paraleximit ata mësojnë të dëgjojnë, të flasin mirë dhe më vonë të lexojnë mirë.

Me librin nga çanta- starti i leximit ju dhe fëmija juaj mund të zbuloni jetën e përditshme në Gjermani. Ndërsa duke e shikuar atë, ju mund të mësoni së bashku me fëmijën tuaj edhe fjalët e para gjermane.



### Zbuloni jetën e përditshme këtu



#### Libri tregon fotografi nga jeta në Gjermani:

Në kopshtin e fëmijëve, gjatë ngrënjes së drekës, përjashta ose në fermë – në çdo faqe ka shumë për të parë.

Flisni me fëmijën tuaj në lidhje me tregimet me fotografi. Krejt vetvetiu futeni kështu në bisedë: mbi shumë përjetime, për miq dhe për mjedisin e ri.

### Njohja e fjalëve

Përmes librit ju mund të ushtroni së bashku fjalët e para gjermane.

Libri me ilustrime dhe fjalë "Emma dhe Samir" ju tregon fjalët gjermanisht për disa gjëra të jetës së përditshme. Por Ju mund edhe thjeshtë të tregoni diçka në gjuhën e juaj dhe t'i vëni emrin gjërave të ilustruara me figura.



### Paraleximi & Tregimi



**Paraleximi i përbashkët dhe e treguara sjellin kënaqësi dhe janë të rëndësishme për të mësuar për të lexuar!**

Gjatë paraleximit (leximit me zë të lartë) fëmija juaj do të mësojë të flasë, të shprehë ndjenjat e tij, të përqëndrohet. Sepse paraleximi krijon afërsinë midis prindit dhe fëmijës. Kjo ndodh në çdo gjuhë.

Ju vetë nuk jeni të informuar me librat dhe leximin? Mos u shqetësoni: kurrë nuk është tepër vonë për të filluar paraleximin. Libri i fton të gjithë për të treguar.



Seti është në dispozicion tuajin në kuadër të programit „Lesestart für Flüchtlingskinder“. Ai është realizuar nga Fondacioni i Leximit me porosi të Ministrisë Federale të Arsimit dhe Studimit. Më shumë informata rreth programit ju i gjeni nën adresën [www.lesestart-fuer-fluechtlingskinder.de](http://www.lesestart-fuer-fluechtlingskinder.de).

**Argëtim të këndshëm gjatë paraleximit dhe tregimit!**